

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION U.S.C.  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA D.D.

24-04-2026

Nr. 3121  
PRISHTINË - A



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION U.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Për:  
**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRRE

Kopje:  
**Artane Rizvanolli**  
Ministre – Ministria e  
Ekonomisë  
**Bordi i KEK**  
**Bordi i ZRRE**

Data: 22.04.2026

Nga: **Gramos Hashani**  
Kryeshef Ekzekutiv (UD)  
Korporata Energjetike e Kosovës  
Sheshi Nënë Tereza nr. 36  
Prishtinë, 10000  
Republika e Kosovës  
[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

### **Çështja: Komentet e KEK në Raportin Konsultativ.**

I nderuar z. Fejzullahu,

Korporata Energjetike e Kosovës Sh. A ka shfrytëzuar mundësinë e konsultimit publik në lidhje me Raportet Konsultative për të hyrat e lejuara maksimale për FSHU, OSSH dhe OST, për të parë dhe analizuar vlerësimin e ZRRE-së në lidhje me koston e blerjes së energjisë nga KESCO, KEDS dhe KOSTT e të cilat ndërlihen me blerjet vendore, përkatësisht blerjet nga KEK-u.

Siç jeni njoftuar, para se palët të dorëzojnë Aplikimet e tyre për shqyrtimin tarifor “Kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për vitin tarifor 2026/27”, KEK ka zhvilluar diskutime për rishikimin e çmimeve të energjisë elektrike, krahasuar me çmimet ekzistuese të cilët përfundojnë me datën 31.03.2026 kur edhe përfundon viti tarifor 2024/25. Në kuadër të këtyre diskutimeve, KEK ka dërguar zyrtarisht njoftimin për përfundimin e marrëveshjes për çmime me datën 31.03.2026 dhe propozimin e çmimit të rishikuar që do të zbatohet nga data 01.04.2026.

Pas ndryshimeve ligjore që rregullojnë sektorin e energjisë të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016, ZRRE ka amendamentuar legjislacion sekondar për të qenë në harmoni me legjislacionin primar, prandaj në këtë kuptim çmimet e prodhimit për gjeneratorin publik KEK nuk rregullohen nga ZRRE që nga viti 2017, por ato i nënshtrohen kushteve të tregut.

### **Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit të Shërbimit Universal**

Në raportin e publikuar nga ZRrE përmenden sfidat operacionale të njësive gjeneruese në Kosova A dhe Kosova B dhe çmimi i pandryshuar i KEK SH.A. për FSHU, por nuk përmendet kërkesa e KEK në **shkresën protokoll 241 të datës 13.01.2026** e drejtuar KESCO-së (Kopje ZRRE).

### **Komentet e KEK Sh.A**

KEK Sh. A në shkresën e lartpërmendur ka propozuar që çmimi i energjisë elektrike për KESCO nga data 01.04.2026 deri 31.03.2027 të mbetet njëjtë pra 29.50 €/MWh sa është aktualisht, me kusht që propozim ndryshimet e çmimeve për blerje të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmision dhe shpërndarje nga palët respektive (KOSTT dhe KEDS), të pranohen si të tilla.

Gjithashtu, me kërkesë të ZRRE-së dhe me qëllim të profilizimit të kostove dhe shmangies së rritjes së tarifave për konsumatorët universal, KEK SH.A është pajtuar me KESCO në parim që faturat për energjinë e furnizuar nga KEK ndaj KESCO-së që faturat Janar-Mars 2026 të riprogramohen për pagesë gjatë vitit tarifor 2027.

**KEK.sh.a kërkon nga ZRRE që në rast të ndryshimeve në tarifat OSSH dhe OST ndaj KESCO-së marr parasysh këtë kërkesë dhe të njëjtën ta miratojë.**

### **Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OSSH-së**

Në raportin e publikuar nga ZRrE për OSSH në pikën 2.2 dhe 2.3 përmenden se Blerjet nga KEK bëhen me një çmim të rregulluar prej 36.0 €/MWh, ndërsa Blerjet e importeve bëhen me çmimet e tregut, ndërsa në asnjë pikë nuk përmendet fakti se validiteti i aneks-marrëveshjes në mes të KEK Sh.A. dhe KEDS ka përfunduar më 31.03.2026 dhe as kërkesa e KEK në **shkresën protokoll 242 të datës 13.01.2026** e drejtuar KEDS-së (Kopje ZRRE).

### **Komentet e KEK.Sh.A**

Si edhe që tash me është bere e ditur, KEK është në zbatim të investimeve jetike për efikasitetin, jetëgjatësinë e njësisve dhe standardet mjedisore. Gjatë 2026 do të ketë ndalesa të gjata, me rënie të prodhimit dhe të hyrave, ndërkohë që, për shkak të specifikave teknologjike, rreth 45% e shpenzimeve operative janë fikse. Mbajtja në operim e kapaciteteve varet nga mbulimi i kostove reale përmes çmimit të faturuar. Çdo mungesë e njohjes së kësaj kostoje rrezikon sigurinë e furnizimit.

KEK Sh. A në shkresën e lartpërmendur ka propozuar që Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në shpërndarje, tani e tutje të llogaritet duke iu referuar çmimeve të tregut, përkatësisht çmimeve mesatare Day Ahead (një ditë para) të Bursës ALPEX.

Meqë çmimi i faturimit nga KEK reflekton kostot e prodhimit e të investimeve kapitale për mbajtjen në operim të njësisve, KEDS dhe ZRRE duhet të qartësojnë mekanizmin se si kjo kosto do të reflektohet në zinxhirin tarifor deri te konsumatori fundor.

Përndryshe, ndikim bazik në faturën e konsumatorit fundor nuk është çmimi i energjisë për humbje, por sasia e humbjeve teknike dhe jo-teknike që reflektohen në tarifa. Sa më e lartë sasia e humbjeve, aq më e madhe është kostoja totale që bartet te konsumatorët fundor, pavarësisht çmimit për njësi. Përndryshe, çdo diskutim për ulje të çmimit vetëm sa e zhvendos barrën financiare te KEK-u.

Prandaj KEK Sh.A. kërkon nga palët në këtë proces, pra KEDS gjatë aplikimit dhe ZRrE gjatë shqyrtimit, të respektojnë bazën dhe frymën ligjore që kanë qëllim efikasitetin e kostos dhe çmimin me të mire në treg, transparencën dhe barazinë e palëve si: *Nenin 22(paragrafët 2, 4, 5 dhe 7), dhe 23(paragrafët 5 dhe 7, si dhe pikat pika 9 përkatësisht 9.13 – 9.16), të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Procedura për Tregtimin e Energjisë Elektrike PR-MO-11 (Paragrafi 1, 2, 3), vendimet e ZRrE (V\_1637\_2022, V\_1638\_2022, V\_1748\_2023), çmimi i energjisë elektrike në tregun e Kosovës përcaktohet në mënyrë konkurruese në tregun e organizuar (ALPEX) dhe Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (të miratuar nga ZRRE më 18 Janar 2017) Nenin 1(pika 1), Nenin 2(pika 2.1), Nenin 4(pikat 1, 2, 3 dhe 4) dhe marrëveshjes së BSA-së neni 5.2*, **të marrë parasysh këtë kërkesë për Çmimet për vitin tarifor 2026/2027 dhe të njëjtën ta miratojë.**

## **Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT**

Në raportin e publikuar nga ZRrE në pikën 3.3 përmendet se “KOSTT deklaroi se nuk ekziston asnjë marrëveshje alternative për prokurimin e energjisë për të mbuluar humbjet përveç marrëveshjes me KEK-un, e cila ka qenë në fuqi që nga viti i kaluar dhe për të cilën ZRRE-ja është informuar siç duhet. Lidhur me parashikimet për vitin aktual, KOSTT u mbështet në njoftimet zyrtare të marra nga KEK-u në lidhje me ndryshimin e marrëveshjes ekzistuese të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve. Sipas këtij njoftimi, duke filluar nga muaji prill, KEK parashihte të siguronte energji nga bursa e energjisë ALPEX” siç është paraqitur edhe në **shkresën protokoll nr. 244 të datës 13.01.2026**.

Në raportin Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale të OST/OT nuk është përmendur kërkesa e KEK.Sh.A drejtuar KOSTT-it (kopje ZRrE), përmes **shkresës protokoll 243 të datës 13.01.2026** për zbritjen-kthimin e çmimit të Tarifës për Operim të Sistemit per prodhim te kyqur ne transmetim.

### **Komentet e KEK.Sh.A**

KEK Sh. A në shkresën shkresën protokoll 244 të datës 13.01.2026 drejtuar KOSTT-it (Kopje ZRRE), ka propozuar që Çmimi i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim, Bazuar në :[ *Nenin 22(paragrafët 2, 4, 5 dhe 7), dhe 23(paragrafët 5 dhe 7, si dhe pikat pika 9 përkatësisht 9.13 – 9.16), të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Procedura për Tregtimin e Energjisë Elektrike PR-MO-11 (Paragrafi 1, 2, 3), vendimet e ZRrE (V\_1637\_2022, V\_1638\_2022, V\_1748\_2023)çmimi i energjisë elektrike në tregun e Kosovës përcaktohet në mënyrë konkurruese në tregun e organizuar (ALPEX) dhe Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (të miratuar nga ZRRE më 18 Janar 2017) Nenin 1(pika 1), Nenin 2(pika 2.1), Nenin 4(pikat 1, 2, 3 dhe 4) ], tani e tutje të llogaritet duke iu referuar çmimeve të tregut, përkatësisht çmimeve mesatare Day Ahead (një ditë para) të Bursës ALPEX duke eliminuar marrëveshjen e datës 31.10.2024 protokoll (KEK) nr.7586 “Shtojcë e MBE-së ndërmjet KOSTT(OST) dhe KEK-Përdorimi i Kontratës për Diferencë (CfD) dhe rrjedhimisht edhe marrëveshjen e datës 14.08.2017 protokoll (KEK) nr.188 “Marrëveshje për Blerjen e Energjisë për Mbulimin e Humbjeve në Rrjetin e Transmetimit dhe Sistemit”.*

Marrëveshja për çmimin e energjisë për mbulimin e humbjeve është kontraktuar mes KEK dhe KOSTT. Si edhe është cekur me larte, bazuar ne kornizën ligjore, nga vitit 2017, ZRRE nuk miraton çmimin e shitblerjes mes palëve. Përgjegjësia rregullatore konsiston në njohjen e këtij shpenzimi si kosto e arsyeshme e KOSTT-it në kuadër të përcaktimit të Hyrave të Lejuara Maksimale.

**Si rrjedhim, KEK Sh.A kërkon nga ZRrE që marr parasysh këtë kërkesë për çmimin e energjisë per mbulim te humbjeve ne transmetim, dhe të njohë shpenzimin e KOSTT që rrjedh nga kontrata me KEK si kosto të justifikuar.**

KEK Sh. A në shkresën **shkresën protokoll 243 të datës 13.01.2026** drejtuar KOSTT-it (Kopje ZRRE) ka bërë kërkesë për zbritjen-kthimin e çmimit të Tarifës për Operim të Sistemit duke marrë në konsideratë faktin se rritja e fundit me efekt nga 1 Maj 2025 në vlerën **89.59%** të tarifës për Operim të Sistemit ( në **5.682 €/MWh** nga **2.997 €/MWh**), ka prodhuar efekt direkt në koston e prodhimit të energjisë elektrike për KEK-un, ku vetëm për periudhën Maj 2025-Dhjetor 2025 efekti financiar arrin shumën **8,349,049.51€**.

### **Komentet e KEK.Sh.A**

Duke parë mundësinë për rishikimin e tarifave për operimin e Sistemit nga KOSTT, si dhe mundësinë për vendimin për uljen e çmimit për operim të Sistemit per prodhimin e kyqur ne transmetim nga **5.682 €/MWh** në **2.997 €/MWh**, dhe me qëllim që kjo ulje të reflektohet në mënyrë të drejtë dhe të saktë në

përlllogaritjet financiare ndërmjet palëve, KEK përmes këtij dokumenti kërkon zbritje të kësaj tarife dhe kthimin e tarifës të para datës 1 Maj 2025 në vlerë **2.997 €/MWh** bazuar në nenin 37 pika 6 të ligjit për energjinë elektrike L-05/L-85.

**Në këtë kontekst, dhe me qëllim që ky ndryshim të reflektohet në mënyrë korrekte në përlllogaritjet financiare dhe raportimet përkatëse, kërkohet që kjo zbritje/kthim i çmimit të mëparshëm të trajtohet dhe të zbatohet në përputhje me kornizën rregullative në fuqi dhe marrëveshjet ekzistuese ndërmjet KEK-ut dhe KOSTT-it.**

Me respekt,



**Gramos Hashani**

**Kryeshef Ekzekutiv (UD)**